VENDIM
Nr.499, datë 19.7.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË DIVJAKË TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Divjakë të qarkut të Fierit.

Lista me 108 (njëqind e tetë) fletë përfundon me numrin rendor 723 (shtatëqind e njëzet e tre).

2. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Divjakës, sipas tabelës në lidhjen nr.1 dhe që i referohet pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme dhe bashkia e Divjakës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha